

Master Profesional në Edukim, *profili* “Mësimdhënia dhe të Nxënët”

Programi i studimit Master Profesional në Edukim me profil “Mësimdhënia e të Nxënët” synon që studentët të fitojnë kompetencat e duhura profesionale të planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programit bazuar në kompetencat kyçe evropiane, të teorive dhe praktikave më të mira të mësimdhënies dhe të të nxënët, të metodologjive ndërvepruese dhe atyre të nxitjes së të menduarit kritik sipas filozofive më të suksesshme të edukimit, por dhe njohje të thelluar të veçorive psikologjike të fëmijëve, të adoleshentëve dhe të të rriturve.

Kurrikula

- o Teoritë e të Nxënët dhe Modelet e Mësimdhënies;
- o Diversiteti i Nxënësve në Klasë;
- o Metodatat e Kërkimit në Edukim;
- o Hartimi dhe zbatimi i kurrikulës;
- o TIK në Mësimdhënie dhe të Nxënët
- o Vlerësimi për të Nxënët dhe i të Nxënët



Karriera

Mundësi punësimi:

- o si mësues në të gjitha profilet në institucionet parashkollore;
- o si mësues në shkollat të arsimit bazë dhe të mesëm (gjimnaze dhe shkollat profesionale);
- o në institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore të arsimit lidhur me zhvillimin dhe politikbërjen arsimore.

Kohëzgjatja & Forma e studimit

Studime me kohë të plotë

Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **2 vite akademik.**

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **4 vite akademikë**

Kriteret

- o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
- o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehësuar nga MASR/QSHA.

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehësuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UniBa.



Kontakte të departamentit:

☎ +355 69 20 67 247 | +355 69 20 41 222

✉ Email: ieb@umb.edu.al